



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 6 Prot

Tiranë, më 03.04.2012

VENDIM Nr. 1 dt. 30.03.2012

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 30.03.2012, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

Lidhur me:

I. Diskutim mbi problematikën e mozaikut të Orfeut të Durrësit

Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të MTKRS dhe IMK, për të negociuar me pronarët e banesës në të cilën ndodhet mozaiku i Orfeut në qytetin e Durrësit, për të bërë të mundur ruajtjen dhe vizitueshmërinë e tij.

II. Diskutim mbi problematikën në Kishën e Manastirit të Mesopotamit.

Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të IMK dhe MTKRS, i cili do të vendosë mbi ecurinë e mëtejshme të zbatimit të projektit të restaurimit për Manastirin e Mesopotamit.

III. Shqyrtimi i rregullores "Pazari i i Bilishtit".

Miratohet: Rregullorja e "Pazarit të Bilishtit". Të përcillet në MTKRS rregullorja dhe harta e zonifikimit për miratim në instancat përkatëse.

IV. Diskutimi i projekteve të financuara nga buxheti i shtetit.

1. **Miratohet:** Projekt restaurimi i godinës së selisë së “Qeverisë Provizore” të Ismail Qemalit, Vlorë. (Muzeu i pavarësisë).
 2. **Miratohet:** Projekt i ndërhyrjeve vlerësuese dhe restaurimit në muzeun etnografik Vlorë, (Klubi Labëria).
 3. **Miratohet:** Projekt restaurimi i godinës së ish prefekturës Vlorë.
 4. **Miratohet:**Projekt rikonstruksioni i godinës ku është formuar Komiteti i Kosovës, Shkodër.
 5. **Miratohet:** Projekt restaurimi i banesës Pashko Vasa, Shkodër (faza e II).
 6. **Miratohet:**Projekti i restaurimit dhe konservimit të rrënojave të kalasë së Aulonës, Vlorë.
 7. **Miratohet:** Projekt restaurimi kisha e Ungjillizimit, Kozarë, Kucovë, Berat (Pikturamurale+Tavani).
 8. **Miratohet** Projekt restaurimi kisha e Ungjillizimit, Kozarë, Kucovë, Berat. (Arkitektura), **me sugjerimin: Të ruhet një pjesë e suvatimit të brendshëm tek Oxhaku.**
- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
 - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
ALDO BUMÇI



SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE

